



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

---

V E N D I M

Nr. 69, Datë 10/06/2013

Mbështetur në nenin 32/1, germa a) dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10021/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar ankesën e znj.

ne Nr. Regjistri 84, datë 20.12.2012, në të cilën pretendohet për diskriminim nga ana e Komunës Grabian, për shkak të racës.

Në shpjegimin e saj ankuesja shkruan se: “*Djali i saj z. [emri i djalit] nuk ka të ardhura dhe shtëpi, djali ka tokë por nuk ka të ardhura që ta punojë*”.

Në shpjegimet e saj znj. [emri i gruas] arkon që djali i saj të pajiset me shtëpi nga Komuna Grabian.

*Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:*

- Me shkresën Nr. 10 prot, datë 07.01.2013 u njoftua Komuna Grabian duke e vënë në dijeni për fillimin e procedurave të shqyrtimit të ankesës si dhe duke i kërkuar informacion mbi ankesën e bërë nga subjekti ankues.
- Me shkresën Nr. 9 prot, datë 07.01.2013 subjektit ankues ju kërkuar që të dërgojë pranë Komisionerit, dokumente plotësuese dhe informacion shtesë mbi ankesën e bërë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga znj. [emri i gruas] Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

Me shkresën Nr. 22/1 prot, datë 14.01.2013, Kryetari i Komunës Grabian, i është drejtuar Komisionerit me sqarimin se: Bazuar në nenin 1, pika 2 e ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar me ligjin nr. 9719, datë

23.04.2007 dhe i ndryshuar së fundmi në vitin 2012 me ligjin nr. 54, "Ky ligj e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin nën juridiksionin e bashkive të Republikës së Shqipërisë, ndërsa për territorin nën juridiksionin e komunave do të zgjidhet me një ligj të veçantë", nuk ka përfituar dhe nuk është përfshirë në asnjë program, për sa i përket programeve sociale për strehimin e banorëve. Për këtë arsye banorët e pastrehë të Komunës Grabian nuk kanë përfituar banesa sociale.

Vihet re se nga ana e Komunës Grabian nuk kemi të bëjmë me një trajtim të ndryshëm ndaj banorëve, pasi bazuar në përgjigjet e përcjella drejt Komisionerit nga Komuna Grabian, nuk ka asnjë familje që ka përfituar banesa sociale nga ana e kësaj Komune sepse si njësi vendore, nuk ka përfituar dhe nuk është përfshirë në asnjë program, për sa i përket programeve sociale për strehimin e banorëve, për këtë arsye banorët e kësaj Komune nuk mund të përfitojnë banesa sociale.

Për sa i përket trajtimit me ndihmë ekonomike të familjes Komisioneri vlerëson se, zbutja e varfërisë nëpërmjet ofrimit të ndihmës ekonomike, për familjet dhe individët në nevojë rregullohet nëpërmjet Ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore" i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 787, datë 14.12.2005 "Për Përcaktimin e Kritereve të Procedurave dhe të Masës së Ndhimës Ekonomike".

Qëllimi i këtij ligji është përcaktuar në nenin 1 ku shprehimisht thuhet se:

1. Të përcaktojë ndihmën dhe shërbimet shoqërore për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe të mundësive personale dhe ruajtjen e integritetit për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore.
2. Të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët dhe familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre.

Në analizë të qëllimit për të cilin është hartuar ky ligj, vërejmë se ndër objektivat kryesorë të rregullimeve që mbulon ky ligj është gjendja ekonomike e individëve dhe grupeve në nevojë.

Në nenin 5 të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", citohet se: "Përfitues të ndihmës ekonomike janë familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme", ndërsa në nenin 19, pika 2 të po këtij ligji, citohet se: "Ndhima ekonomike është e pjesshme kur familja pretenduese ka të ardhura të pamjaftueshme nga toka, bagëtia, shpendët, vreshtaria e kopshtaria, pensionet dhe të ardhura të tjera", nga sa më sipër, familjet e Komunës Grabian të cilat nuk kanë të ardhura ose të ardhurat e tyre janë të pamjaftueshme për të plotësuar nevojat jetike, nuk përjashtohen nga skema e ndihmës ekonomike, këto familje mund të përfitojnë ndihmë ekonomike të pjesshme edhe nëse janë të pajisura me tokë.

Në nenin 29, pika 1, të këtij ligji parashikohet se: "Këshilli i bashkisë/komunës ka përgjegjësi të miratojë fondin dhe numrin e familjeve në skemën e ndihmës ekonomike" dhe pika 2 e këtij neni

citon: “Këshilli i bashkisë/komunës ka përgjegjësi që me fondet e veta, në bazë të kritereve specifike, mbështet me ndihmë ekonomike, apo forma të tjera ndihme të menjëhershme, familjet e varfra”.

Duke analizuar për sa më lart, Komuna Grabian ka detyrim ligjor që të mbështesë me ndihmë ekonomike familjet në nevojë dhe ato të varfra. Fakti që këto familje mund të jenë të pajisura me tokë, nuk e përjashton përgjegjësinë e kësaj njësie vendore që të mbështesë me ndihmë ekonomike apo forma të tjera ndihme banorët e saj. Gjithashtu Këshilli i Komunës Grabian duhet të kishte marrë masa që familjet në nevojë të kësaj njësie vendore, të ishin trajtuar me ndihmë ekonomike.

Bazuar në kreun XI, pika 9 e udhëzimit të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr. 338/3, datë 10.03.2006 Mbi zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 787, datë 14.12.2005 “ Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, ku citohet: “Drejtoria rajonale organizon takime, seminare si dhe organizon kualifikimin personal të administratorëve pranë seksioneve të ndihmës ekonomike në bashki a komunë”, si dhe në pikën 10 ku parashikohet: “Administratorët e seksionit të ndihmës dhe të përkujdesit në bashki/komuna janë përgjegjës për zbatimin e legjislacionit, si dhe raportojnë përpara këshillit të komunës, si dhe kryetarit të bashkisë/komunës”, administratori i seksionit të ndihmës ekonomike pranë Komunës Grabian bazuar më lart, duhet të kishte marrë masa që shqetësimin e banorëve të kësaj njësie vendore ta kishte përcjellë në Këshillin e Komunës, në mënyrë që të ishte marrë një vendim dhe të ishin marrë masat e menjëhershme në zgjidhjen e kësaj situate.

Komuna Grabian, në kompetencat e përbashkëta me pushtetin qendror, ka detyrim kujdesin social dhe zbutjen e varfërisë, bazuar në nenin 11, pika 3/c e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ku sanksionohet se: “Komunat duhet të ndërmarrin bashkëpunim me pushtetin qendror për kujdesin social, zbutjen e varfërisë dhe garantimin e funksionimit të institucioneve përkatëse”

Neni 1 i Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcakton se “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”. Pra siç shihet personat për shkak gjendjes ekonomike gëzojnë mbrojtje nga sjelljet diskriminuese apo që e nxisin atë.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata

ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3 citon: *“Diskriminim i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë”.*

Në çështjen Thlimmenos kundër Greqisë<sup>1</sup>, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka mbajtur qëndrimin se: *“.....e drejta për mbrojtjen nga diskriminimi përfshin jo vetëm detyrimin e trajtimit të barabartë të personave në situata të njëjta, por dhe trajtimin ndryshe të personave në situata të ndryshme.....”*<sup>2</sup>.

Komuna Grabian, në zbatim të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”, nuk ka bërë asnjë vlerësim mbi gjendjen ekonomike të banorëve dhe as të nevojave të komunitetit në njësinë vendore që administron duke arsyetuar se ato komuna që përfshihen në kategorinë e njësisive vendore të cilat janë të pajisura me tokë nuk përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike.

Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se praktika e ndjekur nga Komuna Grabian, duke mos shqyrtuar kërkesat e banorëve për ndihmë ekonomike, duke i trajtuar të gjithë këto familje njëllor pa marrë parasysh kushtet e ndryshme që mund të kishin, përbën diskriminim substantiv (trajtim i barabartë i çështjeve të pabarabarta) për shkak të gjendjes ekonomike, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, pasi cenon të drejtën e banorëve të Komunës Grabian për përfitim të ndihmës ekonomike, e drejtë kjo e njohur nga ligji nr.9355, datë 10.03.2005 “Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”.

Subjekti ankues, në përgjigje të kërkesave të Komisionerit për informacion dhe shpjegime, nuk ka shprehur interesim dhe nuk ka kthyer asnjë përgjigje.

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, geramat a), nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

<sup>1</sup> Thlimmenos kundër Greqisë, Kërkesa nr. 34369/97, vendimi me datë 06.04.2000

<sup>2</sup> Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, hyrë në fuqi në datë 02.08.1996) dhe jurisprudenca e GJEDNJ janë të detyrueshme për tu zbatuar bazuar në nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

## VENDOSI:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të znj. \_\_\_\_\_, për shkak të racës.
2. Konstatimin e diskriminimit të banorëve të Komunës Grabian, për shkak të gjendjes ekonomike nga ana e Komunës, duke mos i ofruar shërbimin e ndihmës ekonomike.
3. Komuna Grabian, në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10021/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

